

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

25.10.2023

Ora 13:13

**RENDI I DITËS**


**"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
nr. 32, datë 19.10.2023".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. E. Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,  
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S'ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. K. Bele:** Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës nr. 32, e cila është bërë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për vendosjen e sanksionit administrativ", drejtuar KAS-it, lidhur me një denoncim të bërë nga Qëndresa Qytetare me nr. 413 ID "Për shkelje administrative nga kryetari dhe kandidati për kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe si dhe ndaj drejtorit të Shkollës 9-vjeçare "Fran Murati", Petroshan Malësi e Madhe. Komisioneri ka propozuar vendosjen e sanksionit administrativ, duke dërguar bashkëlidhur dokumentacionin. KAS është me pjesëmarrje të plotë të pesë anëtarëve, administrata e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Prezencë të palëve nuk ka. Relatohet nga ana e administratës një kërkesë e drejtuar nga ana e Qëndresës Qytetare, shoqatë e cila ka vënë në lëvizje Komisionerin lidhur me këto pretendime administrative të cilat ne po i shqyrtojmë sot. Si e tillë ka një interes të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

ligjshëm në këtë proces. Megjithatë diskutojmë me kolegët, do të shprehem në një moment tjetër në lidhje me këtë kërkesë. Dëgjojmë mendimin e Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me këtë fazë të procesit ku po verifikojmë nëse kemi shkaqe dhe rrethana të cilat lejojnë kalimin në seancë.

**Z. Y. Merkaj:** Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është marrë denoncimi me nr. 413 ID, nga Qëndresa Qytetare për shkelje administrative nga ana e kryetarit dhe kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve janë konstatuar shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Komisioneri në bazë të nenit 19, pika 1, të Kodit Zgjedhor, ka vendosur t’ia propozojë KAS-it marrjen e masës administrative për zotën Tonin Marinaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe dhe zotit Kastriot Dragaj, drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Fran Murati”. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje të sanksionit administrativ”, konstatohet se është në përputhje me nenin 126, 130 të Kodit Zgjedhor si dhe me nenin 35, të rregullores së KAS-it. Në këto kushte i propozojmë KAS-it, kalimin e kërkesës së Komisionerit për shqyrtim, faleminderit!

**Z. K. Bele:** Pyetje? pavarësisht kërkesës së palës së interesuar, duke qenë se ne në këtë fazë në fakt jemi duke shqyrtuar kalimin, apo jo në seancë dhe duke qenë se kemi një praktikë të konsoliduar për kalimin e këtyre kërkesave, pavarësisht prezencës, apo jo të palëve të interesuara. Me qëllim dhe ekonomizimin e procesit, KAS i konsultuar në vend vendosi:

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

- Kalimin e praktikës së kërkesës nr. 32 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në seancë. Duke caktuar ditën e nesërme datë 26.10.2023, ora 13:00, për shqyrtimin në themel të kësaj kërkesë. Ju lutem merrni masa për njoftimin e subjektit, palës së interesuar.

Me kaq këtë seancë e deklaroj të mbyllur!

**Vendimi nr. 183**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

**25.10.2023  
Ora 13:19**

***RENDI I DITËS***


**"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
nr. 33, datë 19.10.2023".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. E. Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,  
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S'ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. E. Çefa:** Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës nr. 33, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për vendosje sanksioni administrativ" Pas shortit të hedhur në KQZ, relator i kësaj kërkesë, jam caktuar unë, anëtari Elvis Çefa. Verifikojmë fillimisht prezencën. Është prezent trupa e plotë e KAS-it. Është prezent administrata e KQZ-së në drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Nuk ka prezencë nga persona të tjerë. Pra, personi ndaj të cilit propozohet sanksioni, kryetari i Bashkisë Maliq, nuk është prezent. Po ashtu dhe nga pala denoncuese që është deputeti zoti Edmond Spaho, nuk ka prezencë, apo përfaqësi të tyre. Në këto kushte, ne vijojmë me shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes. Fillimisht po i kaloj fjalën Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së!

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar dy denoncime të ardhura nëpërmjet postës elektronike dhe të regjistruara më nr. 417 ID nga zoti Edmond Spaho, deputet në Kuvendin e Shqipërisë për një veprimtari të ndaluar në Bashkinë Maliq. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim këtë denoncim dhe në përfundim të shqyrtimit administrativ ka konstatuar se, janë kryer veprime me veprimtari të cilat janë në shkelje të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri duke vlerësuar se ka shkelje, ka vendosur t'i propozojë KAS-it, marrjen e masës administrative në masën 3 000 lekë për zotën Gëzim Topçiu, kyetar i Bashkisë Maliq. Nga verifikimi paraprak i kërkesës së Komisionerit “Për vendosje të sanksionit administrativ”, me nr. 33, konstatohet se është në përputhje me nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 34, 35 të rregullores së KAS-it. Në këto rrethana, i kërkojmë KAS-it, kalimin e kërkesës së Komisionerit për shqyrtim, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Faleminderit zoti Merkaj! Pyetje nga kolegët? Nuk ka! Atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi:

- Pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 33, “Për vendosje sanksioni administrativ”, ndaj kryetarit të Bashkisë Maliq. Caktimin e seancës së shqyrtimit të kësaj kërkesë, ditën e nesërme, në datën 26.10.2023, ora 13:30. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur!

**Vendimi nr. 184**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

**25.10.2023  
Ora 13:23**

***RENDI I DITËS***

**"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
nr. 34, datë 19.10.2023".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. E. Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali,  
z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** S'ka prezent
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. L. Braho:** Pranë KAS-it është depozituar kërkesa "Për vendosje sanksioni administrativ" e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 34, për një denoncim që është bërë nga KRIIK-u, në lidhje me Bashkinë Kamëz. Të pranishëm nuk ka, është vetëm administrata e KQZ-së. Ka marrë dijeni pala ndaj së cilës kërkohet vendosja e sanksionit administrativ dhe nuk janë të pranishëm. Komisioneri ka hetuar denoncimin nr. 402 të KRIIK-ut dhe në fund i propozon KAS-it marrjen e masës administrative ndaj zotit Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Kamëz, gjobë në masën 3000 lekë. Po ashtu ka bashkëlidhur dhe vendimin 797, të datës 6.10.2023, që ka kryer shqyrtimin administrativ të këtij denoncimi. Atëherë, zoti Sekretar i Përgjithshëm, në lidhje me

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.25.10.2023*

objektin e verifikimit paraprak që janë elementët e formës dhe përmbajtjes së kërkesës!

**Z. Y. Merkaç:** Kërkesa e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 34 “Për vendosje të sanksionit administrativ” është në përputhje me nenin 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor si dhe nenin 34, 35 të rregullores së KAS-it. Në këto rrethana, i kërkojmë KAS-it, kalimin e kërkesës në seancë për shqyrtim, faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Atëherë, KAS i konsultuar në vend vendosi:

- Kalimin për shqyrtim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 34, si dhe caktimin e seancës së shqyrtimit administrativ, në datën 26.10.2023, ora 14:00. E deklarojmë seancën të mbyllur!

**Vendimi nr. 185**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

